



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223458
Datë: 06.06.2022
Numri i dokumentit: 03098598

K.nr.996/21

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN, përmes gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në lëndën për kundërvajtje ndaj të pandehurit A. K nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse – mospërfillje e urdhrave të ligjshme të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr. 03/L-124, sipas kërkesës së Stacionit Policor, Qendra në Gjilan nr. **2021-CA-...** të dt. **16.09.2021**, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 87, 119 dhe 142 të Ligjit mbi Kundërvajtjet më datë **06.06.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. K, nga babai K..., i lindur më ... me vendbanim në Gjilan në lagjen "...", i pa punë, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse më datë **16.09.2021**, në orën **14:00**, derisa njësitë reagues ALFA 7/3 ishim duke patrolluar në këmbë në rrugën "R.I" të lagjes "..." ish Kamniku kemi hasur në një person me emrin A. K i cili nuk kishte të vendosur masken. Me ta parë kemi kërkuar nga ky i fundit që të ndaloj pasi që ne ishim në anën tjetër të rrugës mirëpo i njejtë nuk e ka përfillur urdhërin tonë dhe ka filluar të vrapoj në drejtim që të dërgon mbrapa ndërtesave të kaltërta të lagjes "Iliria", gjatë vrapimit disa herë policia e kemi urdhëruar që të ndaloj mirëpo i njejtë nuk i është bindur urdhërit që të ndaloj, ku ka vrapuar deri tek ndërtesa e kompleksit banesor "Bujana Group", e

që është afër qendres tregtare ETC dhe INTER EX dhe është futur në bodrumin e saj ku edhe njësjia patrolluese e ka gjetur të dyshuarin dhe e ka futur nënkontroll dhe e ka shoqëruar për në Stacionin Policor të Gjilanit. Personi i lartshënuar për policin është i njohur për disa vepra siç janë Blerja, Posedimi, Shperndarje dhe Shitje e paautorizuar e narkotikëve si dhe substancave psikotrope dhe analoge.

-me çka ka bërë veprë kundërvajtëse- mospërfillje e urdhrave të ligjshme të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr. 03/L - 124 ,

Prandaj, në bazë të dispozitës së cekur më lartë shpallet përgjegjës dhe

D Ë N O H E T

ME DËNIM GJOBE në shumë prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me dhunë në kuptim të nenit 163.4 të LK-së.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj kësaj gjykate shumen prej **5 euro** në afat të njejtë si edhe denimin.

Nga një kopje e aktgjykimit t`ju dorzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Stacioni Policor në Gjilan, ka parashtruar kërkesën nrë. **2021-CA-...** të dates **16.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit te lartecekur, për shkak të veprës kundërvajtëse – mospërfillje e urdhrave të ligjshme të parashikuar dhe të ndëshkuar nga neni 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike Nr. 03/L -124, dhe ka kërkuar që të njejtin ta shpalli përgjegjës dhe ta denojë sipas ligjit.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike ftoj me ftesë të pandehurin, i cili në seancë gjyqësore deklaroi se është e vërtetë se me datën **16.09.2021** në ora **14:00**, vërtetë ishte në lagjen e Kamnikut duke ecur dhe vërtetë masken nuk e kishte të vendosur dhe me ta vërejtur policia i dhënë shenjë për tu ndalur dhe i njejtin ka vazhduar rrugën dhe nuk është ndalur me arsyetim se kishte pasur frikë dhe ka tentuar të fshihet dhe ky ka qenë qëllimi i veprimit në atë mënyrë dhe se asgjë tjetër të pa ligjshme nuk kishte bërë andaj për këtë i vie keq që ka ndodhur, kërkon ndjesë, kërkon falje, është penduar për këtë rast, premtori se në të ardhmen nuk do të përsërisë

kësi veprimi dhe lut gjykatën që kësaj here pasi që është i pa punë, me kushte të vështira materiale ti mer parasysh këto rrethana dhe t'i shqiptoi një dënim sa më të vogël minimal.

Gjykata me kujdes shtjelloi të gjitha provat materiale, deklaratën e të pandehurit dhe shkresave të tjera në lëndë dhe arriti në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elemente të kryerjes së veprës kundërvajtëse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi vepër kjo e paraparë dhe e ndëshkuar nga neni 16 par.1 i Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike.

Gjyqtari me rastin e vendosjes mori për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 të LMK-së dhe të njejtit të pandehur i shqiptoj dënimin me gjobë duke menduar se një dënim i tillë është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës kundërvajtëse dhe me shkallën e përgjegjesisë duke konsideruar që edhe me një gjobë të këtillë do të arrihet qëlimi i dënimit që i njejtë në të ardhmen mos të përsërisë kundërvajtje të kësaj natyre.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në mbështetje të nenit 109 të ligjit mbi kundërvajtjet.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJILAN
Me date: 06.06.2022

Zyrtarja ligjore,
Erzë Mustafa

Gjyqtari,
Menderes Behluli

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes këtij Divizioni Kundërvajtes.